



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM**

U R D H Ë R

NR. 163 DATË, 01.10. 2007

PËR

**KRIJIMIN DHE CAKTIMIN E STRUKTURËS ORGANIKE, FUNKSIONIMIN DHE
KOMPETENCAT E SEKSIONEVE PËR TË MITUR NË PROKURORITË E RRETHEVE
GJYQËSORE**

Me synim, krijimin, caktimin e strukturës dhe organikës, funksionimin dhe caktimin e kompetencës tokësore të seksioneve për të mitur në Prokuroritë e rretheve gjyqësore;

Në mbështetje, të nenit 148, pika 2 e Kushtetutës, të neneve 24 pikat 4 e 25 pika 1, gërma "a" të K. Pr. Penale, të neneve 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të dekretit të Presidentit të Republikës, nr. 5351, datë 11. 06. 2007 "Për krijimin e seksioneve të veçanta penale për gjykimin e të miturve pranë Gjykatave të rretheve gjyqësore",

URDHËROJ:

**I. KRIJIMI I SEKSIONEVE, STRUKTURA ORGANIKE DHE
KOMPETENCA TOKËSORE E TYRE**

1. Krijimin e seksioneve për ndjekjen penale dhe ngritjen e akuzës në gjykim për të mitur në Prokuroritë e rretheve gjyqësore, pranë Seksioneve të Veçanta Penale për Gjykimin e të Miturve në Gjykatat e rretheve gjyqësore, me kompetenca tokësore, si më poshtë:

1.1. Në Prokurorinë e rrethi gjyqësor Tiranë, seksion i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Tiranë, Krujë, Kurbin, Mat, Mirditë, Bulqizë dhe Dibër.

1.2. Në Prokurorinë e rrethi gjyqësor Durrës, seksion i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Durrës, Kavajë, Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.

1.3. Në Prokurorinë e rrethi gjyqësor Shkodër, seksion i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Shkodër, Lezhë, Malësi e Madhe, Pukë, Tropojë, Kukës dhe Has.

1.4. Në Prokurorinë e rrethi gjyqësor Vlorë, seksion i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Vlorë, Fier, Mallakastër, Lushnjë, Berat, Skrapar dhe Kuçovë.

1.5. Në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Korçë, seksion i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Korçë, Pogradec, Kolonjë dhe Devoll.

1.6. Në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Gjirokastrë, seksion i cili do të shtrijë veprimtarinë në rrethet Gjirokastrë, Sarandë, Tepelenë dhe Përmet.

2. Struktura organike e seksioneve për të mitur, do të jetë, si më poshtë:

2.1 Në Seksionin për të Mitur në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë, caktohen 3 (tre) prokurorë, 2 (dy) oficer të policisë gjyqësore-jurist.

2.2 Në secilin Seksion për të Mitur në Prokuroritë e rretheve gjyqësore Durrës, Shkodër, Vlorë e Korçë caktohen nga 2 (dy) prokurorë dhe nga 1 (një) oficer të policisë gjyqësore-jurist.

2.3 Në Seksionin për të Mitur në Prokurorinë e rrethit gjyqësorë Gjirokastrë caktohen 1 (një) prokurorë dhe 1 (një) oficer i policisë gjyqësore-jurist.

3. Prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore-jurist dhe personeli administrativë, që caktohen nga drejtuesi i Prokurorisë në Seksionet për të Mitur në zbatim të këtij urdhri, në vartësi të volumit të punës, kryejnë edhe detyra të tjera që i ngarkohen prej tij.

4. Në Seksionet për të Mitur të caktohen prokurorët dhe opgj-juristët më me përvojë në ndjekjen e çështjeve ndaj të miturve, ata që kanë marrë pjesë në kurse kualifikimi lidhur me garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore në hetim dhe ngritjen e akuzës ndaj të miturve, si dhe prokurorët magistratë.

5. Në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, pranë Drejtorisë së Hetimit dhe të Kontrollit të Ndjekjes Penale caktohet një prokuror për të miturit, i cili duhet të ketë eksperiencë dhe njohuri të mira në garantimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore në hetimin dhe gjykimin e të miturve.

III. DISA VEÇORI LIDHUR ME FUNKSIONIMIN

1. Me hyrjen në fuqi të dekretit të Presidentit të Republikës, datë 1 shtator 2007, në Prokuroritë e rretheve gjyqësore ku janë krijuar Seksionet për të Mitur do të bëhet kalimi i akteve¹ ose transferimi² i procedimeve, për të vazhduar ndjekja penale, deri në zgjidhjen përfundimtare të të gjithë:

¹ Shih, neni 28 i K. Pr. Penale

² Shih, po aty, neni 89

kallëzimeve, referimeve nga policia gjyqësore apo ankimeve, procedimeve penale në hetim, akteve lidhur me ekzekutimin e vendimeve penale dhe të mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit, si dhe probleme të tjera në ndjekje, duke kryer veprimet përkatëse ligjore dhe administrative.

3

2. Të gjitha çështjet penale të përfunduara, para hyrjes në fuqi të dekretit, për të cilat është ngritur akuzë në Gjykatat e rretheve gjyqësore në të cilat nuk ka seksione të veçanta për gjykimin e të miturve, përfaqësimi i akuzës në gjyq, si rregull, do bëhet nga prokurorët që kanë ushtruar ndjekjen penale në hetimet paraprake, duke u pajisur me autorizim përkatës për përfaqësimin e akuzës në gjykatat pranë të cilave janë krijuar dhe funksionojnë seksionet e veçanta për gjykimin e të miturve.

3. Me datë 1 shtator 2007 e në vijim, për veprat penale të kryera nga të miturit, referimi i veprës penale tek prokurori nga policia gjyqësore, kallëzimi nga nëpunësit publik ose personeli mjekësor apo kallëzimi ose ankimi në prokurori nga ana e shtetasve do të behët në atë Prokurori të rrethit gjyqësor, seksioni për të miturit i të cilës ka në kompetencë tokësore ushtrimin e ndjekjes penale dhe ngritjen e akuzës në gjykatë ndaj të miturve.

IV. DISA RREGULLIME ADMINISTRATIVE

1. Administrata e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe e Prokurorive të rretheve gjyqësore në të cilat krijohen Seksionet për të Miturit, të marrin masa për pajisjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të këtij seksioni me zyra, pajisje kompjuterike, mjete të tjera logjistike, automjete dhe me personelin e nevojshëm administrativë për fillimin e funksionimit normal të tyre.

V. NJOHJA, ZBATIMI, KONTROLLI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET

1. Me këtë urdhër të njihen oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe drejtuesit e prokurorive të të gjithë niveleve, si dhe personeli i administratës në Prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm.

2. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen prokurorët, drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve, drejtuesit-prokuror të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe personeli administrativë dhe Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Zyre.

3. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Kon&Komp KL
28.09.07

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU